



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit bëhet ndërmjet

Komunës së Gjakovës,

dhe

Jakova Innovation Center (JIC)

Gjakovë, 03 Dhjetor 2018

Neni 1

Qëllimi

Me anë të kësaj marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Jakova Innovation Center (JIC), Komuna e Gjakovës pajtohet që të bëjë bashkëfinancim te projektit “Smart Bin” i përkrahur fillimisht nga organizata Balkan Green Foundation (BGF), si zbatues kryesor i projektit “Empower – Engage – Build Ownership” të fianancuar dhe menaxhuar nga Bashkimi Evropian që përfaqësohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti “Smart Bin” (Nr. REF i Projektit: C-01-2018/SG-13), është financuar në vlerën 5,000.00 Euro, nga donatori i cekur më lartë. Komuna së Gjakovës do të ndajë mjete shësë në vlerën **3,000.00 Euro** për aktivitetet në vijim:

- Krijimi dhe vendosja e shportave të mencura për mbledhjen e mbeturinave/bërllokut,
- Kampanja vetdijësuese për mbrojtjen e ambientit dhe mos-hudhjen e mbeturinave në rrugë,

- c) Fokus-grupe me të gjithë hisedarët e projektit, institucione publike, shoqërinë civile dhe qytetarët dhe
- d) Raport me rekomandime për zgjerimin e aktiviteteve dhe hapat e mëtejshëm në mbrojtje e ambientit.

Neni 2 Kohëzgjatja e projektit

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e të dyja palëve dhe mbaron me përbushjen e obligimeve kontraktuale të të dyja palëve.

Marrëveshja aktuale e mbulon periudhën prej 01 Nëntor 2018 deri me 31 Mars 2019. Me pajtimin e të dyja palëve nënshkruese, kjo marrëveshje mund të vazhdohet edhe pas përfundimit të afatit kohorë të dhënë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Kjo *Marrëveshje* është e një natyre tërësisht rekomanduese dhe do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e palëve.

Kjo *Marrëveshje* është përgatitur në tri kopje në gjuhën shqipe:

- Një kopje për Komunën e Gjakovës;
- Një kopje për Jakova Innovation Center (JIC);
- Një kopje për arkivin e Komunës së Gjakovës.

Komuna e Gjakovës


Kryetar z. Ardiq Gjini




Vulosur nga Komuna e Gjakovës

Jakova Innovation Center (JIC)

Drejtore Ekzekutivë z. Fatos Axhemë



Vulosur nga Jakova Innovation Center



Datë: 03 Dhjetor 2018

Gjakovë